

TË DHËNAT TEKNIKE

Karakteristika	Komponenti A	Komponenti B
Pamja:	Pluhur	Lëng
Paketimi:	Thes letre 25 kg	Bidon 8 kg
Ngjyra:	Gri	Bardhë
Konsumi:	1.6 kg/m ² /mm trashësi	
Magazinimi:	Të ruhet në vënde të thata mbi paleta druri.	
Koha e magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit.	
Masa vëllimore:	1.65 gr/cm ³	1.1 gr/cm ³
pH i përzierjes:	12	
Granulometria:	0.7 mm	
Temperatura e aplikimit:	+5C deri në +35C.	
Trashësia për shtresë:	1.5 - 2 mm	
Koha midis dy duarve:	4-6 orë	
Shkelshmëria:	24-48 orë	
Aplikimi i pllakave sipër bëhet:	Pas 3-5 ditë	
Koha e pritjes për vendosjen e qeramikës:	4-5 ditë	



dekoll®
PREMIX PER L'EDILIZIA



Autostrada Durrës-Tiranë, km 5
Durrës, Albania
Tel: +355 69 606 6656
Email: info@dekoll.al
www.dekoll.al



Hidroizolim total



Rezistent ndaj agentëve atmosferikë



Hidroizolues për banjo, dushe, ballkone, bodrume, tarraca dhe pishina



dekoll®
PREMIX PER L'EDILIZIA

HIDROFIX II

www.dekoll.al

PËRSHKRIMI

Material hidroizolues dykomponent me fleksibilitet të lartë me bazë çimento, inertesh të seleksionuar, me aditiv specifik dhe polimer fleksibël. Me punueshmëri të mirë dhe falë rezinave organike përbërëse ka aftësi shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve (gjithmonë të qëndrueshme dhe të pastra) në betone, mure, dhe pllakë. Duke krijuar një shtresë fleksibël dhe të pa përshkueshme nga uji. Përdoret për ambiente të jashtme dhe të brendshme.

FUSHA E APLIKIMIT

Ka veti shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve si suva, dysHEME dhe sipërfaqe betoni. Është i përshtatshëm për pllaka parafabrikate. Përdoret për hidroizolim në banjove, duzeve, ballkoneve, bodrumeve, tarracave dhe pishinave. Është mbrojtës i sipërfaqeve të betonit nën efektin e lagështirës së vazhdueshme në rastet e kontaktit me ujin e detit, klorureve, sulfateve, etj.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent, të rregullt, pa vajra, jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Dyshemetë tradicionale me bazë çimento, me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhonimi të paktën 28 ditë. Bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhet të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Hidhni komponentin B të lëngshëm (8 KG) në një enë të pastër dhe duke e përzier hidhni komponentin A të thatë (25KG). Përzieni me një përzierës mekanik derisa të arrihet një masë homogjene, pa kokrriza dhe pa fluska ajri.

APLIKIMI

Aplikoni produktin në dy shtresa me furçë, rul ose shpatull, duke aplikuar rreth 2 mm për çdo dorë. Vëndosni në dorën e parë një rrjetë me fibra qelqi mbi produktin e njomë. Dora e dytë aplikohet pas një periudhe prej 4-6 orësh nga njëra-tjetra dhe jo para tharjes së dorës së parë. Produkti përdoret vetëm duke kombinuar komponentin A me komponentin B dhe në sasinë e rekomanduar. Aplikoni produktin në temperatura nga +5°C deri +35°C.

